




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs
Inspektorati Policor i Kosovës



RAPORTI VJETOR 2022

©Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst ndryshe nga se raportohet këtu.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (Inspektoratit Policor të Kosovës) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë, leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet. Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,

Rruga “Dëshmorët e Gollakut”,p.n, Hajvali, Prishtinë,

Tel: 038 200 19 691,+383 (0)38 521 201

E-mail: zimp.ipk@rks-gov.net

inspektoratipolicor@gmail.com

SHKURTESAT

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DBI	Divizioni për bashkëpunim dhe informim
DCAF	Geneva Centre for Security Sector Governance
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
DI	Departamenti i Inspektimeve
DMA	Departamenti për Menaxhimin e Ankesave
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRK	Drejtoria Rajonale Kufitare
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DH	Departamenti i Hetimeve (IPK)
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të Kaluarës
ICITAP	Internacional Criminal Investigative Training Assistance Program
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
SPK	Stacioni Policor Kufitar
SPMK	Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit
TI	Teknologjia Informative
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

PËRMBAJTJA

1.	RRETH NESH	6-6
2.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	7-7
3.	HYRJE.....	8-8
4.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9-9
5.	MENAXHIMI I ANKESAVE	11-15
6.	HETIMET PENALE	17-25
7.	INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE	27-40
8.	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI	41-46
9.	SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE.....	47-50

1. RRETH NESH

Historik i shkurtër

IPK është mekanizëm i pavarur mbikëqyrës, i pavarur nga Policia e Kosovës dhe funksionon sipas modelit të vendeve perëndimore që aplikojnë standarde të larta ndërkombëtare të kontrollit policor dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Është themeluar në korrik të vitit 2006 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2005/54 dhe Urdhëresës Administrative nr.2006/9, si Agjenci Ekzekutive në kuadër të MPB-së. Bazuar në këto akte, ka funksionuar deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-136 për IPK-në, të miratuar në vitin 2008. Më pas, për shkak të ndryshimit të mandatit ligjor në fushën e hetimeve, nga viti 2010, IPK-ja funksionon bazuar në Ligjin nr. 03/L-231, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2010.

Fushëveprimi

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është:

1. Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
2. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;
3. Hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe

zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;

4. Kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje disiplinore, Kryeministri mund të autorizon Inspektoratin Policor të Kosovës për zhvillim të hetimeve disiplinore. Inspektorati Policor i Kosovës pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat;

5. Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

Misioni

Misioni i IPK-së është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Vizioni

IPK synon fuqizimin e rolit të tij në funksion të rritjes së integritetit, profesionalizmit dhe ofrimit të shërbimeve profesionale dhe etike për qytetarët.

Parimet tona

Si një agjenci e përkushtuar për t'iu shërbyer interesave të të gjithë qytetarëve, IPK-ja udhëhiqet nga vlerat, si: përgjegjshmëria, profesionalizmi, objektiviteti, paanshmëria, mosdiskriminimi, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti.

2. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Inspektorati Policor i Kosovës bazuar në misionin e vet ligjor, gjatë vitit 2022 ka arritur të evidentoj rezultate që kanë ndikim pozitiv për rendin dhe sigurinë e Republikës së Kosovës. Këto rezultate pozitive tregojnë për dedikimin e secilit punonjës të IPK-së, prandaj në fillim duhet të falënderoj secilin punonjës në IPK.



Falë punës dhe angazhimit të tyre të pakursyer, Inspektorati Policor i Kosovës edhe në vitin 2022 ka evidentuar suksese në përmbushjen e misionit të IPK duke fuqizuar besimin e qytetarëve në këtë agjenci të zbatimit të ligjit. Ky fuqizim i besimit të qytetarëve është shprehur në trendin e numrit të ankuesve.

Trajtimi i mbi 1600 ankesave në IPK ka të bëjë edhe me rritjen e besimit të qytetarëve në punën, profesionalizmin dhe transparencën e Inspektoratit Policor të Kosovës. Prandaj, Inspektorati Policor i Kosovës është shumë mirënjohës ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim, të cilët kanë bashkëpunuar ngushtë me Inspektoratin Policor të Kosovës dhe kanë dhënë kontributin kryesor për të garantuar një shërbim profesional, demokratik dhe transparent të Policisë së Kosovës. Hetuesit dhe inspektorët në IPK kanë dëshmuar nivelin më të lartë të profesionalizmit në punë edhe gjatë vitit 2022. Në njërën anë falë punës së hetuesve në IPK në vitin 2022 është evidentuar një rritje e numrit të kallëzimeve penale kundër punonjësve policor për vepra të ndryshme penale.

Në fokus të IPK-së edhe këtë vit ka qenë luftimi i korrupsionit, në kuadër të angazhimeve tona këtë vit me sukses janë realizuar operacionet Pika 1 dhe Pika 2 që konsiderohen ndër operacionet më të suksesshme të realizuara në luftimin e korrupsionit.

Në anën tjetër inspektorët kanë përfunduar me sukses të lartë gjithsej dymbëdhjetë (12) inspektime në fusha të ndryshme policore nga të cilat kanë derivuar 54 rekomandime për Policinë e Kosovës.

IPK falënderon partnerët ndërkombëtarë duke përfshirë këtu ICITAP-in, OSBE-në të cilët ndihmuan IPK-në edhe këtë vit në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe teknike duke realizuar 25 trajnime për stafin operativ.

Inspektorati Policor i Kosovës do të vazhdojë të mbetet i përkushtuar për të përmbushur në mënyrë profesionale dhe transparente të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e veta ligjore, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë qytetarët e vendit dhe institucionet tjera kompetente.

3. HYRJE

Ky është Raport përmbledhës i punës së IPK-së për periudhën janar - dhjetor 2022, i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. Raporti i këtij viti pasqyron sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe.

Në drejtim të ngritjes së transparencës dhe ofrimit të informacionit për qytetarëve mbi punën që bëjmë, IPK-ja praktikon që të publikojë një dokument përmbledhës në standardin e një Raporti të rregullt vjetor, ku pasqyrohen sfidat dhe angazhimet tona në përmbushje të përgjegjësive dhe misionit ligjor.

IPK vlerëson se nga viti në vit puna jonë vazhdon të jetë më cilësore dhe këtë e dëshmojnë rezultatet tejet mbresëlënëse. Rezultatet konsiderohen se janë të përbashkëta, ngase pjesë të suksesit tonë bartin dhe qytetarët që ofruan një bashkëpunim në denoncimin e shkeljeve nga radhët policore, por edhe partnerët tanë që na mbështetën në këtë rrugëtim.

Përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me funksionet e saj, IPK i ka të ndara në departamente. Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për punonjësit e IPK-së, agjencia jonë është e strukturuar në pesë (5) departamente, prej të cilave, katër (4) janë operative dhe një (1) mbështetës. Roli i secilit departament është i shtjelluar në brendësi të këtij Raporti.

Raporti i këtij viti është i ndarë në disa kapituj, ku pasqyrohen aktivitetet e departamenteve, rezultatet e punës dhe sfidat në arritjen e rezultateve.

IPK-ja do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit, në përmbushje të mandateve që dalin nga Ligji për IPK-në, në drejtim të sigurimit që Policia e vendit tonë të zhvillohet si forcë e përgjegjshme, profesionale dhe demokratike. Ky mision konsiderohet i rëndësishëm për ne, andaj dhe interesi ynë është që Policia të zhvillohet krahas standardeve ndërkombëtare.

Në përfundim të kësaj hyrjeje, vlerësojmë se edhe pse kemi ofruar disa dritare të informimit të qytetarëve mbi angazhimet tona, ne zotohemi se edhe në të ardhmen do të vazhdojmë t'iu ofrojmë informacionin me kohë dhe për kureshtjen tuaj, siç vazhdon të jetë edhe kjo praktikë e raportimit e shprehur përmes këtij Raporti.

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë përmbledhje janë pasqyruar informata të dala nga analizat e kryera mbi performancën e organizatës në të gjitha drejtimet, bazuar në mandatet e përcaktuara me Ligjin për IPK-në.

Jemi angazhuar që të rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e trajtimit të ankesave:

- Kemi administruar **1697** ankesa, të pranuar në mënyra të ndryshme;
- **34%** të tyre i orientuam për hetim penal në Departamentin e Hetimit;
- Pjesën e mbetur prej **66%** i kemi orientuar për hetim disiplinor Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës.

Ne u angazhuam në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keq-menaxhimit policor:

- Kemi hetuar **257** punonjës policorë;
- Kemi ngritur **77** kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar **108** punonjës dhe qytetarë nën dyshimin për përfshirje në krim;
- Kemi rekomanduar suspendimin e **164** punonjësve policorë.

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuam dymbëdhjetë (**12**) inspektive të planifikuara dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtjesore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluam **qindra** dosje administrative (penale, financiare, prokurimit, etj., dhe realizuam dhjetëra intervista;
- Rekomanduam avancimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së **54** rekomandimeve;
- Verifikuam përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve dhe transparencës për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi **60** komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi **200** kërkesa të tyre;
- Realizuam takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj.;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore.

5. MENAXHIMI I ANKESAVE

Departamenti i Menaxhimit të Ankesave (tutje si DMA) është ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së, që ka për objekt të veprimtarisë: pranimin e të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimin dhe përcaktimin, se cilat nga to hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë apo institucioneve përgjegjëse¹.

Qytetarët e vendit dhe ata të huaj mund të paraqesin ankesë në DMA lidhur me pretendimet e tyre se ndonjë nga pjesëtarët e Policisë ka kryer detyrat në kundërshtim me rregullat e sjelljes.

Ankesë konsiderohet çdo parashtresë e drejtuar në IPK nga ndonjë individ ose grupi interesit, me të cilën shprehen shqetësimet lidhur me sjelljen devijante të punonjësve policorë apo kur parashtresa ka të bëjë me standardet policore apo udhëzimet operative.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DMA-së janë:

- të sigurojë realizimin e politikave e procedurave të organizatës në menaxhimin e ankesave dhe të informacionit të disponueshëm mbi dyshimet për përfshirje të punonjësve të Policisë në vepra të kundërligjshme;
- të sigurojë mbajtjen e evidencave/regjistrave për ankesat dhe mbi bazën e tyre nxjerrë statistika me të dhëna për raportime;
- të sigurojë që informatat që posedon IPK-ja mbahen/ruhen sipas ligjeve përkatëse;
- të sigurojë që ankesat trajtohen duke u bazuar në parimet e përcaktuara me Ligjin e IPK-së².

Bazuar në Rregulloren mbi organizimin e brendshëm, DMA-ja përbëhet nga dy divizione:


- Divizioni i Trajtimit të Ankesave;
- Divizioni i Administrimit të Lëndëve,

DMA ka të punësuar tetë (8) punonjës.

¹ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

² Neni 15 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017

Faktet kyçe (indiktorët):



Pranimi i ankesave

DMA gjatë vitit 2022 ka administruar gjithsej 1.697 ankesa të natyrave të ndryshme. Bazuar në të dhënat statistikore të pesë (5) viteve të fundit, del se deri në vitin e kaluar pranimi i ankesave ka pasur trend rritës, por më i theksuar ka qenë viti 2020 dhe 2021 të njohura si vite me ndikim pandemik, kur edhe numri i ankesave ka qenë më i shtuar. Viti 2022 ka shënuar një rënie prej 15.7% krahasuar me një vitin paraprak dhe kjo si duket është rezultat i zbutjes masave kundër Covid. Rezultatet pasqyrojnë se ekziston trend i ngritjes së vazhdueshme të numrit të ankesave që besohet se ka ardhur për shkak të vetëdijesimit dhe ngritjes së besueshmërisë së qytetarëve tek institucioni ynë, gjë që e dëshmojnë edhe matjet e kryera nga institucione kredibile. Kjo performancë rezulton si rezultat i punës që bëjnë punonjësit e IPK-së, qoftë në rrafshin e përmbushjes së mandateve, promovimin e vlerave dhe sensibilizimin qytetar.



Mënyrat e pranimit të ankesave

Sipas akteve ligjore e nënligjore të IPK-së, qytetarët kanë mundësi të ndryshme që të procedojnë ankesat e tyre. Nëse i referohemi statistikave të viteve të fundit, shihet se edhe këtë vit qytetarët më së shumti kanë preferuar që ankesat e tyre t'i dorëzojnë përmes postës elektronike, për shkak edhe të përdorimit gjithnjë e më shumë të teknologjisë informative. Dorëzimi i ankesave fizikisht në IPK si dhe dorëzimi përmes postës, po ashtu janë ndër mënyrat më të shpeshta që preferojnë qytetarët.

Tabela nr. 1-Të dhëna përmbledhëse mbi numrin e ankesave dhe mënyrat e paraqitjes së tyre

Nr.	Mënyrat e parashtrimit të ankesave në IPK	Numri	Përqindja
1	Ankesa të pranuar në formë elektronike	570	33.6%
2	Ankesat e pranuar fizikisht në IPK dhe zyrat rajonale	513	30.2%
3	Ankesa të pranuar përmes postës	132	7.8%
4	Ankesa (inicime) nga Departamenti Hetimeve	104	6.1%
5	Inicime nga DMA	5	0.3%
6	Ankesa të pranuar përmes institucioneve tjera	16	0.9%
7	Ankesa të pranuar përmes Policisë së Kosovës	269	15.9%
8	Inicime të brendshme nga Policia e Kosovës	88	5.2%
	Gjithsej	1697	100%

Bazuar në të dhënat nga tabela më lartë, del se 1.324 ankesa (78.1%) janë pranuar nga mënyrat që ofron IPK (renditja sipas numrave rendor 1, 2, 3, 4 dhe 5), derisa përmes Policisë së Kosovës janë pranuar 269 ankesa (15.9%) dhe 88 inicime të brendshme (5.2%), kurse 16 raste apo (0.9%) janë pranuar nga institucioneve tjera. Ankesa të pranuar nga zyrat rajonale të IPK-së janë si vijon: 40 ankesa të pranuar në Gjilan, 26 ankesa të pranuar në Prizren dhe 2 ankesa të pranuar në Mitrovicë Veriu.


Kualifikimi i ankesave

Gjatë vitit 2022, 585 ankesa (34.5% e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar në IPK) janë kualifikuar si ankesa që përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në vepra penale. Këto ankesa janë proceduar në Departamentin e Hetimeve të IPK-së për trajtim/hetim të mëtejshëm.

Numri prej 1.104 ankesave (65.1 % e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar në IPK) janë kualifikuar se përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në shkelje disiplinore, dhe të njëjtat janë proceduar në Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës.

Gjatë këtij viti janë evidentuar katër (4) raste (0.2%) që janë proceduar në Departamentin e Hetimeve të IPK-së për t'u trajtuar për shkelje disiplinore në përputhje me mandatin ligjor, tre (3) raste të proceduara në Departamentin e Inspektiveve (0.2%) dhe një (1) rast (0.1%) është proceduar në institucionet tjera përgjegjës (për më tepër shih diagramin nr. 2 si më poshtë). Sipas analizave të bëra, afërsisht 1/3 e ankesave të pranuar janë kualifikuar se përmbajnë elemente të veprave penale, derisa 2/3 e ankesave janë kualifikuar se përmbajnë elemente të shkeljeve disiplinore (shih diagramin nr.2 si më poshtë).

Në lidhje me ankesat e kualifikuara si shkelje disiplinore, janë dërguar 1.104 njoftime zyrtare me shkrim për qytetarët për t'u njoftuar se ankesa e tyre është dërguar për hetim të mëtutjeshëm tek autoriteti kompetent në kuadër të Policisë së Kosovës.



Përkatësia gjinore e ankuesve

Sipas të dhënave të DMA-së, në vitin 2022, gjithsej 1.351 ankesa janë adresuar nga persona të gjinisë mashkullore, derisa 211 ankesa janë adresuar nga persona të gjinisë femërore. Për pjesën e mbetur prej 135 ankesave, nuk ka qenë e mundur të dihet gjinia, për shkak të mënyrës që është përzgjedhur të ushtrohet ankesa dhe këtu hyjnë iniciimet zyrtare nga DMA-ja, iniciimet e brendshme, ankesat anonime dhe ankesat që kanë ardhur nga institucionet tjera. DMA është interesuar të njihet me faktin se sa ka ndërruar raporti gjinor sa i përket personave që kanë adresuar ankesa në IPK ku kemi këto rezultate (shih tabelën nr. 2).

Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2020	%	2021	%	2022	%
1	Meshkuj	1.288	77.7	1.603	79.6	1.351	79.6
2	Femra	149	9.0	233	11.6	211	12.4
3	E panjohur	221	13.3	177	8.8	135	8
	Gjithsej	1.658	100	2.013	100	1.697	100

Përkatësia etnike e ankuesve

Në vitin 2022, gjithsej 1.481 ankesa janë adresuar nga persona të përkatësisë shqiptare, 71 prej tyre nga persona të përkatësisë serbe, tetë (8) nga persona të përkatësisë boshnjake dhe dy (2) të tjera nga shtetas të huaj. Në totalin prej 1.697 ankesave, për 135 ankesat e pranuar në IPK, nuk dihet përkatësia e ankuesve, meqë lidhen me iniciime zyrtare nga DMA, iniciimet e brendshme, ankesat anonime, si dhe ankesat që kanë ardhur nga institucione tjera. Po ashtu, DMA është interesuar të njihet me faktin se sa ka ndërruar raporti etnik sa i përket personave që kanë adresuar ankesa në IPK. Bazuar në dhënat tona zyrtare, IPK-ja gëzon besueshmëri tek të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Me këtë rast, janë analizuar - krahasuar edhe trendët mbi raportin në mes të personave sipas etnive që kanë ushtruar ankesa në IPK për tre (3) vitet e fundit (shih tabelën nr. 3).

Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2020	%	2021	%	2022	%
1	Shqiptar	1379	83.2	1748	86.8	1481	87.3
2	Serb	51	3.1	74	3.7	71	4.2
3	Turq	0	0.0	0	0.0	0	/
4	Boshnjak	4	0.2	10	0.5	8	0.5
5	RAE	0	0.0	0	0.0	0	/
6	Të tjerë të huaj	3	0.2	4	0.2	2	0.1
7	E panjohur	221	13.3	177	8.8	135	8
	Gjithsej	1.658	100	2013	100	1697	100

Ngarkesa mujore me ankesa

Muaji më i ngarkuar me numër të ankesave përgjatë vitit 2022 ka qenë qershori, ku janë regjistruar 174 ankesa (10.3 % e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar gjatë vitit). Tetori ka qenë më së paku nga të gjithë muajt tjerë, i ngarkuar me ankesa të pranuar (115 ankesa apo 6.8 % e numrit të përgjithshëm të ankesave).

Nr.	Muaji	2020	%	2021	%	2022	%
1	Janar	108	6.51	137	6.8	124	7.3
2	Shkurt	123	7.42	127	6.3	149	8.8
3	Mars	129	7.78	158	7.8	168	9.9
4	Prill	84	5.07	166	8.2	128	7.5
5	Maj	102	6.15	148	7.4	138	8.1
6	Qershor	125	7.54	187	9.3	174	10.3
7	Korrik	120	7.24	188	9.3	126	7.4
8	Gusht	159	9.59	179	8.9	170	10.0
9	Shtator	172	10.37	274	13.6	128	7.5
10	Tetor	176	10.62	131	6.5	115	6.8
11	Nëntor	162	9.77	167	8.3	133	7.8
12	Dhjetor	198	11.94	151	7.5	144	8.5
	Gjithsej	1.658	100	2013	100	1697	100

Numri i ankesave në raport me drejtoritë rajonale

Të dhënat e administruara nga Divizioni i Administrimit të Lëndëve i Departamentit të Menaxhimit të Ankesave mundësojnë të kuptojmë edhe drejtoritë policore për punonjësit e të cilave ka pasur ankesa të qytetarëve.

Sipas të dhënave, ankesat më të shumta janë adresuar për punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Prishtinës dhe arrijnë në 45.2 % të numrit të përgjithshëm të ankesave. Ndërsa më së paku ankesa ka për Drejtorinë Rajonale të Policisë Kufitare Mitrovicë - Veriu 0.3 % (shih tabelën nr. 5).

Nr.	Drejtoritë	Numri	%
1	DRP - Prishtinë	766	45.2
2	DRP - Pejë	155	9.1
3	DRP - Ferizaj	159	9.4
4	DRP - Prizren	135	8.0
5	DRP - Gjiilan	161	9.5
6	DRP - Mitrovicë Jugu	135	8.0
7	DRP - Mitrovicë Veriu	59	3.5
8	DRP - Gjakovë	98	5.8
9	DRPK - Veriu	11	0.6
10	DRPK - Lindja	11	0.6
11	DRPK - Perëndimi	7	0.4
12	I pa lokalizuar	0	0
	Gjithsej	1697	100

6. HETIMET PENALE

Departamenti i Hetimeve (D.H) është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007.

Objektiv i veprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj. Hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë; Hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutive etj.³

Departamenti i Hetimeve është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007.

Objektivë e veprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj. Hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë etj.⁴

Përgjegjësitë (detyrat) e Departamentit janë: se kryen hetime penale si dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë, zbaton masat e fshehta hetimore në funksion të fushëveprimit, të autorizuar nga autoriteti kompetent. Zbaton metoda apo teknika të ligjshme për të zhvilluar kapacitetin proaktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit, në kuadër të standardeve të larta profesionale policore.

Bashkëpunon me Prokurorinë në fushën e hetimeve dhe shfrytëzon burime të ligjshme të informacionit për nevoja operative. Nxjerrë raporte mbi rrjedhën e hetimeve të zhvilluara dhe kallëzime penale, ndërmerr veprime të nevojshme ligjore për të siguruar dhe vlerësuar informatat inteligjente. Siguron mbështetje teknike në funksion të hetimeve (përdorë pajisje teknike në funksion të realizimit të masave të veçanta, siguron dhe trajton dëshmi nga vend-ngjarja)⁵.

Hetuesit e zhvillojnë aktivitetin e tyre në tetë (8) divizione. Departamenti ka të punësuar 43 punonjës (Udhëheqës i Departamentit, udhëheqës të divizioneve dhe hetues).

DEPARTAMENTI I HETIMEVE

Departamenti i Hetimeve u angazhuan në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keq menaxhimit policor:


- Kemi hetuar 257 punonjës policorë;
- Kemi ngritur 77 kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar 108 punonjës dhe qytetarë me dyshimin për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme;
- Kemi rekomanduar suspendimin e 164 punonjësve policorë.

³ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁴ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁵ Neni 6 i Rregullores (MPB) nr.01/2017 (Departamenti i Hetimeve).

Raporti përmbledhës për hetimet, përmban aktivitete të realizuara në suaza të detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga dispozitat e përcaktuara në Ligjin për IPK, në veçanti për Departamentin e Hetimeve dhe të dhënat e gjeneruara që posedon DH. Bazuar në të dhënat nga evidencat zyrtare, gjatë vitit 2022, subjekt i hetimit nga IPK, kanë qenë gjithsej 257 punonjës policor, shprehur në përqindje vetëm 2.95% e numrit të përgjithshëm të punonjësve policorë që janë hetuar nën dyshimin se janë përfshirë në veprimtari penale.



Viti 2022 konsiderohet një vit i suksesshëm për DH-në, bazuar në të dhënat lidhur me numrin e rasteve të trajtuara, numrin kallëzimeve penale, numrin e të arrestuarve, të suspenduarve etj.

Në vitin 2022, DH-ja ka pranuar 591 raste përmes Departamentit për Menaxhimin e Ankesave në kuadër të IPK-së, ndërsa 348 raste kanë vazhduar trajtimin nga vitet paraprake në vitin 2022.

Departamenti i Hetimeve ka trajtuar gjithsej: 939 raste, duke përfshirë rastet e bartura nga vitet paraprake si dhe rastet e pranuar në këtë vit (shih tabelën nr.1 si më poshtë).

Tabela nr. 6 Kategorizimi i rasteve dhe hapat procedural	
Gjithsej në punë	939
Të pranuar dhe regjistruara në vitin 2022	591
Në proces nga vitet paraprake	348


Sa i përket rasteve që janë bartur nga vitet paraprak për në vitin 2022, si raste në hetim paraprak, penal dhe disiplinor, trajtimi i tyre është bërë si në vijim:

- 136 raste (39 %) janë proceduar në Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës për hetim të mëtejshëm disiplinor;
- 49 raste (14 %) janë parashtruar në Prokurorin e Shtetit;
- 163 raste (47 %) janë në proces të hetimit paraprak, penal dhe disiplinor si dhe të njëjta vazhdojnë trajtimin në vitin 2023 për trajtim të mëtejshëm.

Nga gjithsej 939 raste të trajtuara në vitin 2022, sa i përket kategorizimit të tyre, rrjedhin të dhënat si në vijim:

- Nën hetim paraprak, në mungesë të elementeve të veprës penale apo dyshimit të arsyeshëm, 395 raste janë proceduar në DHBVK-PK për hetim të mëtutjeshëm administrativo – disiplinor;
- 155 raste janë parashtruar në Prokurorin e Shtetit;
- 05 raste janë trajtuar në aspektin disiplinor administrativ bazuar në ligjin për IPK⁶;
- Ndërsa 29 raste janë mbetur në nivel informate të proceduar në Divizionin e Inteligjencës dhe Analizës në IPK;
- Tutje 22 raste janë bashkangjitur rasteve paraprake;
- 333 raste në proces që vazhdojnë trajtimin në vitin 2023, nga të gjitha vitet paraprake, ku nën hetim paraprak janë 287, nën hetim penal 43 dhe nën hetim administrativo disiplinor 03.

Të gjitha të dhënat e lartcekura janë të pasqyruara në diagramin si në vijim:




IPK-DH gjatë vitit 2022, ka proceduar me kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit gjithsej 77 raste, me raport të veçantë gjithsej 36 raste, kurse me raport informues në prokurori janë proceduar 13 raste me numër penal dhe 29 raste në fazën e hetimit paraprak⁷.

⁶ LIGJI Nr. 03/L-231, Neni 2, paragrafi 1.3, 1.4 dhe 14.5

⁷ Duhet të kihet parasysh se Raportet Informuese parashtrohen edhe në fazën e hetimit paraprak me numër të DMA-së, për

Bazuar në diagramin në vijim shihet se numri i kallëzimeve penale është në rënie të lehtë në vitin 2022, krahasuar me dy vitet paraprake, gjithashtu shihet një rënie e lehtë e dërgimit të rasteve me raport të veçantë, ndërsa ka ngritje të dukshme të dërgimit të rasteve me raport informues nga viti paraprak.



Si rezultat i proceseve hetimore dhe angazhimeve të personelit hetimor, gjithmonë kur janë plotësuar kushtet ligjore, DH-ja ka kryer arrestime e të dyshuarve për përfshirje në veprimtari penale, duke vënë në zbatim dispozitat e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Republikës të Kosovës.


Bazuar në dispozitat e parapara të ligjit nr. 03/L-231 nenin 17 paragrafin 12, DH-ja kur konsideron se është në interes të hetimeve, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë formën e veprimit që mund përfshijë por nuk kufizohet në llojet e suspendimit me pagesë apo transferimin e punonjësve policor.

IPK-ja gjatë vitit 2022, ka realizuar gjithsej: 108 arrestime prej tyre 98 punonjës të Policisë së Kosovës tutje (PK), 08 qytetarë dhe 02 punonjës të Doganës së Kosovës nën dyshimin e arsyeshëm se kanë qenë të përfshirë në veprimtari penale në rastet ku janë hetuar punonjësit e PK-së. IPK në vazhden e veprimeve hetimore ka rekomanduar 164 suspendime dhe 07 transferime në interes të hetimit.

Në diagramin në vijim janë paraqitur numri i zyrtarëve të arrestuar, suspenduar dhe transferuar për vitet 2020-2022.

udhëzime të mëtutjeshme nga Prokurori i Shtetit.

Diagrami nr. 6 - Pasqyra e numrit të të arrestuarve, suspenduarve dhe transfereve (2020-2022)




Divizioni për Mbështetje Teknike pranë DH-së, në përmbushje të detyrave edhe përgjegjësi hetimore, ka mbështetur në kryerje të detyrave Divizionet tjera hetimore, duke qenë pjesë e punëve të tyre, konkretisht në 07 raste, që kanë pasur të bëjnë me natyrën e masave të fshehta në përmbushjen e urdhëresave të lëshuara nga Gjykatat kompetent.

Divizioni për Inteligjencë dhe Analizë pranë DH-së, në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në vitin 2022, ka trajtuar gjithë: 98 informata, nga këto kanë qenë të bartura nga viti paraprak 20 informata, ndërsa ka arritur ti kompletoj 19 informata dhe ti procedoj për hetim të mëtutjeshme për divizionet përkatëse në DH. 79 informata janë në proces vazhdojnë të trajtohen në vitin 2023.


Departamenti i Hetimeve në vazhden e përmbushjes se detyrave dhe përgjegjësi, pas hetimeve paraprake ka proceduar për hetim penal 133 raste në vitin 2022, përderisa prej tyre në Prokurorinë e Shtetit ka proceduar 110 raste, ndërsa 23 raste në proces vazhdojnë të trajtohen në vitin 2023.

Diagrami në vazhdim pasqyron statusin e rasteve penale të trajtuara dhe proceduara vetëm të vitit 2022, si dhe trendët e krahasuara me dy vitet paraprake:


Diagrami nr. 7 - Statusi i rasteve penale të trajtuara nga Departamenti i Hetimeve (2020-2022)



Duke ju referuar rasteve penale të trajtuara nga IPK në koordinim me Prokurorin e Shtetit gjatë vitit 2022, pesë (5) veprat penale më të shpeshta që janë hetuar gjatë vitit 2022 janë të pasqyruara në diagramin si në vijim:



Gjatë viteve të fundit (2020-2022) pothuajse të njëjtat vepra kanë prirë në listën e pesë veprave penale. Ka trend të ngritjes së vazhdueshme për veprat penale; “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Rrezikimi i trafikut publik”, ndërsa ka rënie të lehte të veprave penale “Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”, “Lëndimi i lehtë trupor” dhe “Kanosje”.



Gjatë vitit 2022, DH ka qenë e përkushtuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi, në parandalimin si dhe luftimin e veprimtarive penale të kryer nga punonjësit e Policisë së Kosovës dhe qytetarëve të përfshirë me punonjësit e PK së, e me theks të veçantë në luftimin e veprimtarisë korruptive.

Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare krahasuar edhe me dy vitet paraprake është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela nr. 7 - Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare				
Nr.	Lloji i veprës penale	2020	2021	2022
1	Keqpërdorimi pozitës po autoritetit zyrtar	28	28	39
2	Falsifikim i dokumentit zyrtar	0	01	0
3	Marrje e ryshfetit	3	01	6
4	Ushtrimi ndikimit	1	02	3
5	Zbulimi fshehtësisë zyrtare	0	02	0
5	Dhënie e ryshfetit	0	0	02
6	Përvetësim në detyrë	0	0	0
7	Konflikti interesit	0	0	0
8	Keqpërdorimi informatës zyrtare	0	0	0
	Gjithsej	32	33	50

Tabela nr. 8 në vijim pasqyron të dhënat e veprave penale të trajtuara nga IPK gjatë vitit 2022, të ndara në kapituj duke ju referuar Kodit Penal të Republikës së Kosovës:

Tabela nr. 8 - Lloji i veprave penale	Nr. i veprave
Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës (XIV)	
Neni 140 Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare	1
Veprat penale kundër jetës dhe trupit(XVI)	
Neni 172 Vrasja	1
Neni 173 Vrasja e rëndë	1
Neni 181 Kanosja	12
Neni 182 Ngacmimi	3
Neni 183 Ngacmimi Seksual	2
Neni 184 Sulmi	5
Neni 185 Lëndimi i lehtë trupor	15
Neni 186 Lëndimi i rëndë trupor	3
Neni 188 Mosdhënia e Ndhmës	1
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut (XVII)	
Neni 190 Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të republikës së Kosovës	1
Neni 195 Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike	11
Neni 202 Fotografimet dhe incizimet tjera të paautorizuar	1
Veprat penale kundër integriteti seksual (XX)	
Neni 228 Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit	1
Neni 227 Dhunimi	1

Neni 229 Sulm Seksual	1
Veprat penale kundër martesës dhe familjes (XXI)	
Neni 248 Dhuna në familje	4
Veprat penale të narkotikëve (XXII)	
Neni 267 Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve subsatnace psikotrope dhe ,analoge	1
Veprat penale kundër ekonomisë (XXV)	
Neni 302 Shpërlarja e parasë	1
Veprat penale kundër pasurisë (XXVI)	
Neni 313 Vjedhja	1
Neni 323 Mashtrimi	2
Neni 328 Detyrimi	1
Neni 329 Shantazhi	3
Neni 331 Fajdeja	2
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë (XXVIII)	
Neni 356 Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm	5
Veprat penale të armëve (XXVIX)	
Neni 364 Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materie plasëse	1
Neni 366 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	1
Neni 367 Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	3
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik (XXX)	
Neni 370 Rrezikimi i trafikut publik	8
Neni 371 Ngasja në gjendje të pa aftë apo të dehur	2
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike (XXXI)	
Neni 378 Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre	1
Neni 380 Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale	1
Neni 384 Deklarimet e rreme	2
Neni 389 Manipulimi me prova	2
Neni 390 Falsifikimi i dokumentit	1
Neni 395 Legalizimi i përmbajtjes së rreme	1
Neni 398 Mundësimi i arratisjes së personave të privuar nga liria	2
Veprat penale kundër rendit publik (XXXII)	
Neni 413 Dëmtimi i varrezave apo kufomave	1
Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (XXXIII)	
Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	39
Neni 421 Marrja e ryshfetit	6
Neni 422 Dhënia e Ryshfetit	2
Neni 424 Ushtrimi i ndikimit	3

Policia e Kosovës ka gjithsej 8704 punonjës, nga të cilët 7388 janë zyrtarë policorë me grada të ndryshme, ndërsa personel civil - pa autorizim policore janë 881.

Në tabelat (nr. 9 dhe 10) në vazhdim pasqyrohen të dhënat lidhur me 257 punonjësit policor të hetuar nga IPK-ja, ndarë sipas gradave të zyrtarëve që janë hetuar, si dhe krahasimi me dy vitet paraqike.

Tabela nr. 9 - Raporti në mes të numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe atyre të hetuar										
Të hetuarit sipas Gradave	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Polici ri	Kadet	Shërbyes civil
Numri i punonjësve	29	49	85	154	326	906	5516	323	435	881
Numri i të hetuarve	0	0	1	4	7	17	215	0	0	13

Tabela nr. 10 - Pasqyra e të hetuarve nga Departamenti i Hetimeve ndër vitet 2020-2022										
Të hetuarit sipas Gradave	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Polici ri	Kadet	Shërbyes civil
Viti 2020	1	4	7	4	10	27	147	1	435	7
Viti 2021	0	2	3	2	6	19	172	0	0	9
Viti 2022	0	0	1	4	7	17	215	0	0	13

Policia në bazë të strukturës organizative aktuale përbëhet nga Drejtoria e përgjithshme dhe pesë (5) departamente, ku numrin më të madh të personelit prej 5775 punonjësve e ka Departamenti për Operacione.

Ky Departament përfshin tre divizione: Divizioni për Siguri Publike, Divizionin i Njësitë të Specializuara dhe Divizioni për Komunikacion Rrugor, tetë (8) drejtori rajonale policore dhe 41 stacione policore. Bazuar në këtë shpërndarje të personelit policor edhe numri më i madh i zyrtarëve të hetuar nga IPK-ja është pikërisht nga Departamenti për Operacione.


Tabela në vazhdim pasqyron numrin e punonjësve policor të hetuar nga IPK, të ndarë në strukturën organizative policore. Në Departamenti për Kufi, Departamenti për Shërbime Mbështetëse dhe Departamenti për hetime ka ngritje të numrit të punonjësve që kanë qenë subjekt hetimi në IPK, ndërsa në Departamentin për Operacione ka rënie të dukshme të numrit të punonjësve të hetuar nga

IPK -ja.


Të gjitha të dhënat e lartpërmendura janë paraqitur në tabelën nr. 11 si në vijim:

Tabela nr. 11 pasqyron numrin e punonjësve të hetuar sipas departamenteve	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Departamenti i Përgjithshëm i Policisë	3	1	0
Zv. drejtorja e përgjithshme për operativë	4	0	0
Zv. drejtorja e përgjithshme për resurse	3	0	0
Departamenti për Operacione	164	195	143
Departamenti për Kufi	25	17	97
Departamenti për Shërbime Mbështetëse	3	0	10
Departamenti për hetime	6	0	6
Departamenti i Burimeve Njerëzore	0	0	1

Bazuar në atë se Departamenti për Operacione përbëhet nga tre (3) divizione, të dhënat e paraqitura në diagram tregojnë pasqyrën e shpërndarjes së 143 punonjësve policor të hetuar në Departamentin për Operacione. Pjesa dërmuese e të hetuarve është shpërndarë në Divizionin për Siguri Publike, ku janë strukturuar drejtoritë rajonale dhe stacionet. Bazuar në të dhënat e IPK-së, vërehet një rënie të numrit të të hetuarve për 21 % krahasuar me vitin paraprak ose për 35 punonjës më pak. Të dhënat e lartcekura janë paraqitur në diagramin në vijim:




Diagrami në vazhdim jep pasqyrën e shpërndarjes së të hetuarve në tetë (8) Drejtoritë Rajonale Policore (DRP). Gjatë vitit 2022 janë hetuar 130 punonjës policor të angazhuar në këto drejtori. Diagrami pasqyron se DRP - Prishtinë prinë nga të gjitha drejtoritë me numrin më madh të të hetuarve nga radhët e saj, duke pasur edhe numrin më të madh të punonjësve të shpërndarë në stacione policore. Ngritje të lehtë të numrit të të hetuarve krahasuar me vitin paraprak ka shënuar DRP - Prishtina, DRP Mitrovicë Jug, DRP Mitrovicë Veri dhe DRP - Gjilan, ndërsa ulje të dukshme ka DRP - Prizren, DRP - Ferizaj, DRP - Pejë dhe DRP - Gjakovë.



Departamenti për Kufi, në organizimin e tij strukturor ka edhe tri Drejtori Rajonale të Policisë Kufitare si dhe Aeroportin e Prishtinës. Diagrami në vazhdim jep pasqyrën e shpërndarjes së 115 punonjësve të Policisë Kufitare të hetuar nga IPK-ja krahasuar edhe me dy vite paraprake. Bazuar në diagramin si më poshtë shihet një ngritje e punonjësve policorë të hetuar në Drejtorinë Rajonale të Policisë Kufitare të Perëndimit si rezultat i hetimit dhe realizimit të dy Planeve Operative të IPK-së, të emërtuar si “Pika 1” dhe “Pika 2”.

Diagrami nr. 12 - Shpërndarja e punonjësve policor të hetuar sipas drejtorive rajonale policore kufitare



Bazuar në fushëveprimin ligjor të IPK-së, sa i përket incidenteve të profilit të lartë dhe shkeljeve disiplinore të nivelit të lartë të menaxhimit dhe atyre të nivelit të lartë ekzekutiv, gjatë vitit 2022, DH-ja ka trajtuar 8 raste, prej tyre 5 raste i ka përfunduar.

Tutje, në kuadër të fushë veprimtarisë dhe gjatë përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive në Departamentin e Hetimeve, janë realizuar edhe shumë aktivitete tjera si zhvillimi i hetimeve proaktive me masa të fshehta hetimore, dalja në vend ngjarje, për incidentet të shkaktuar nga punonjësit policor e jo vetëm etj. Po ashtu në këtë periudhë kohore një pjesë e stafit të DH-së, kanë qenë të angazhuar në ekipe hetimor, ku janë realizuar Planet Operativ të IPK-së, të emërtuar “Pika 1”, “Pika 2” dhe “Toto”.

Departamenti i Hetimeve për vitin raportues, ka zhvilluar bashkëpunimin të shkëlqyeshme me të gjitha institucionet ligj zbatuese, si dhe bashkëpunime ndërkombëtare me institucione si motra.

7. INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE

Departamenti i Inspektimit në kuadër të IPK-së funksionon nga korriku i vitit 2006. Objekt i veprimtarisë së Departamentit të Inspektimit është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese . Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore. Kjo mbikëqyrje arrihet duke realizuar inspektime (të rregullta e të jashtëzakonshme). Inspektimi nënkupton vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave nga PK-ja, duke siguruar arritjen e qëllimeve në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara .

Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK, përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit janë: nxjerrja e Planit Vjetor të Inspektimit në fushat e menaxhimit të përcaktuar me Ligjin për IPK-në; kryerja e inspektimeve me iniciativë të vetën, ose me urdhër të Ministrit; sigurimi i informatave nga fushat menaxheriale përmes metodave të autorizuar të marrjes dhe sigurimit të tyre; analizimi dhe vlerësimi i kryerjes së detyrave nga struktura policore; hartimi i raporteve të inspektimit bazuar në standardet e raportimit .

Qëllimi i çdo inspektimi është: që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, parimet dhe procedurat zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet; të përcaktojë nëse burimet shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj; që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me fushën e menaxhimit; të parandalojë shkeljet që mund të kryhen gjatë punës në fushë përkatëse; të identifikojë

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuar 12 inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtësore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluar qindra dosje administrative (penale, financiare, të prokurimit etj) dhe realizuar me dhjetëra intervista;
- Rekomanduar avansimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së 54 rekomandimeve;
- Verifikuar përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.
- Ne punojmë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe jemi të përgjegjshëm për atë që bëjmë.

dobësitë - mangësitë dhe të rekomandojë masa për funksionimin më të mirë.

Departamenti i Inspektimit funksionon sipas Ligjit nr. 03/L-231 për IPK-në. Mbi bazën e Ligjit është hartuar Udhëzimi Administrativ për Inspektime në Policinë e Kosovës. Kurse, për të rregulluar procedurën dhe veprimet e

personelit në përgatitjen, realizimin e punës inspektuese e raportimin, përdoret Udhëzuesi për Procedurën e Planifikimit, Inspektimit dhe Raportimit.

Inspektorët udhëhiqen nga një varg parimesh, përfshirë këtu profesionalizmin, objektivitetin, paanshmërinë politike dhe mosdiskriminimin. Inspektorët zhvillojnë aktivitetin e tyre në dy divizione: Divizionin për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, si dhe në Divizionin e Inspektimit dhe Raportimit. Momentalisht Departamenti i Inspektimit ka të angazhuar 12 punonjës me njohuri e aftësi të duhura në fushat e kontrollit policor që janë në kompetencë për inspektim. Gjatë vitit 2022, nga gjithsej gjashtë (6) trajnime të realizuara kanë përfituar njohuri gjithsej 20 pjesëmarrës. Dy (2) inspektor kanë marrë pjesë në Punëtorinë online, organizuar nga projekti rajonal i DCAF-it. Po ashtu, një (1) inspektor ka qenë pjesë e ekipit të IPK-së që ka realizuar vizitë studimore në Majami të SHBA-ve.

Departamenti i Inspektimit përcjellë rregullin mbi raportimin e përvitshëm mbi aktivitetet nga fusha operationale, por edhe përfaqësimin dhe zhvillimin profesional.

Viti 2022 ishte produktiv për Departamentin e Inspektimit, me gjithë sfidat që vështirësuan arritjen e objektivave tona. Falë angazhimit të inspektorëve janë realizuar 12 inspektime. Ky është tejkallim i pritjeve, kur kihet parasysh se një vit më parë janë realizuar nëntë (9) sosh. Shihet një tejkallim i numrit të inspektimeve në masën prej 33% krahasuar me një vit më parë, që paraqet vitin më të suksesshëm në 10 vitet e fundit. Inspektimet kanë rezultuar me 54 rekomandime. Departamenti përmbushë mandatin ligjor në përputhje me vlerat, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe të përqendruar në nevoja të përdoruesve të shërbimeve. Ne punojmë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe jemi të përgjegjshëm për

atë që bëjmë. Në përmbushje të misionit jemi të përkushtuar në zhvillimin e një policie të përgjegjshme, demokratike dhe profesionale. Këto vlera do të forcojnë besimin e publikut në Policinë e vendit.

Përgjatë periudhës afatmesme kohore 2022 - 2024 jemi orientuar nga Strategjia e IPK-së dhe Plani i saj i Veprimt, nga i cili burojnë edhe planet vjetore të punës. Këto dokumente që janë edhe në frymën e Programit qeveritar, inspektimin e shohin si mekanizëm të duhur në drejtim të parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit në radhët e punonjësve policor. Planet tona bazohen në analiza të risqeve të identifikuar dhe mbi bazën e tyre realizohen inspektime që trajtojnë fusha me interes, fusha këto që mund të prodhojnë efekte negative në zhvillimin e duhur policor. Lidhur me këtë, Departamenti ka kompetencën dhe përgatitjen për të kontrolluar mbarëvajtjen e proceseve brenda Policisë.

Ne jemi të përkushtuar për përmirësimet e vazhdueshme profesionale, duke rishikuar kornizën inspektuese, politikën, procedurat tona, si dhe duke investuar në fuqinë tonë punëtore. Sa i përket kësaj të fundit, viteve të fundit kemi parasysh edhe profilizimin e personelit në fusha të caktuara, duke bërë që fushat inspektuese t'ua besojmë inspektorëve, varësisht prej afiniteteve të tyre. Për dallim nga vitet e kaluara, Departamenti i Inspektimit ka filluar të praktikojë edhe inspektime të shpejta në fusha të ngushta, duke gjeneruar raporte të shpejta. Këto orientime do të na ndihmojnë të mbajmë rrugën e duhur për atë që duam të arrijmë.

Nuk duhet harruar edhe rolin e partnerëve që vazhdojnë të mbështesin Departamentin me programe trajnimi për zhvillim profesional dhe vizita studimore jashtë vendit.

AKTIVITETET OPERATIVE BRENDA PROCESIVE TË INSPEKTIMIT

Inspektimi paraqet mekanizëm kontribuues në ngritjen e përgjegjësisë për zbatimin e ligjit, përdorimin e drejtë të burimeve, ofrimin e shërbimeve cilësore, ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese, lehtësimin e vendimmarrjes dhe përmirësimin e transparencës ndaj publikut. Inspektimi po ashtu identifikon mangësitë në performancën policore të përcaktuar me ligjin përkatës dhe standardet e kërkuara.

Deri në konstatimin e një gjendjeje, nevojitet që të kalohet nëpër disa faza. Kjo bën të kuptohet se inspektimi është proces që domosdo kalon nga një fazë në tjetrën. Procesi i inspektimit nënkupton sistemin administrativ që duhet të përdoret nga IPK për të zhvilluar inspektime në Polici, për të garantuar se strukturat dhe personeli i saj operojnë në përputhje me ligjet, udhëzimet, rregulloret, parimet e procedurat e përcaktuara⁸. Për të pasqyruar hapat nëpër të cilët kalon inspektimi, pasqyrojmë aktivitetet sipas fazave të procesit inspektues.

Planifikimi

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta

Faza e planifikimit ka përfshirë nxjerrjen e Planit Vjetor të Inspektimeve dhe Programeve të punës në frymën e Planit Strategjik. Këtë vit, Departamenti ka qenë pjesë aktive e procesit të nxjerrjes së Planit Strategjik Zhvillimor (2022-2024) që parasheh edhe aktivitetet inspektuese drejt zbatimit të mekanizmit parandalues të korrupsionit dhe keqmenaxhimit në PK. Plani i Veprimit ka paraparë kryerjen e minimum dy (2) inspektimeve të rregullta dhe sipas nevojës apo rrethanave të krijuara, edhe të atyre të jashtëzakonshme. Në fillim vit, Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi ka përmbyllur procesin e Planifikimit Vjetor të Inspektimeve, ku ka identifikuar fusha me risk dhe ka marrë parasysh politikat e realizimit të inspektimeve të baza të rregullta dy-tre vjeçare për fushat e njëjta. Me planet e tashme vjetore parashihen dhe inspektime në fusha të ngushta me raporte të shpejta. Departamenti u ka ofruar akterëve (Ministrisë, Policisë, IPK-së) të bëhen pjesë e procesit të planifikimit, për të siguruar një Plan cilësor, që adreson fushat me rëndësi dhe risk.

Siç parashihet në nenin 25 të Ligjit nr. 03/L-231 të IPK-së, brenda tremujorit të parë të vitit, Udhëheqësi i Departamentit të Inspektimit i ka dorëzuar Kryeshefit Ekzekutiv, Planin Vjetor të Inspektimit. Ky autoritet me datë 10 shkurt 2022 ka miratuar Planin⁹, që ka marrë parasysh obligimet që dalin nga Strategjia, rëndësinë e programeve, risqet e identifikuara, rezultatet e inspektimeve të kaluar, kapacitetet njerëzore të Departamentit të Inspektimit dhe çështjet e patrajuara.

⁸ Neni 4 i Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës.

⁹ Plan Vjetor i Inspektimeve të Rregullta (2022), nr. 04-052-261/9, datë 14.02.22.

Planit Vjetor ka paraparë inspektime në fushat e menaxhimit, si në vijim:

- (a) Administrimi i parave të imëta;
- (b) Administrimi i patentë shoferëve të konfiskuar;
- (c) Menaxhimi i procedurave të arrestimit dhe ndalimit;
- (d) Menaxhimi i prokurimit dhe kontratave;
- (e) Menaxhimi i thirrjeve dhe reagimi policor;
- (f) Verifikimi i të kaluarës kriminale,
- (g) Kontestet gjyqësore,
- (h) Sjellja policore në raport me qytetarët.

Për shkak të rritjes së kërkesave për inspektime të jashtëzakonshme, tre (3) nga inspektimet e planifikuara janë shtyrë për më vonë. Duhet cekur se kapacitetet inspektuese janë fokusuar veç tjerash dhe në kërkesat e dala nga Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv, për realizimin edhe të shtatë (7) inspektimeve të jashtëzakonshme, si:

- (a) Vlerësimi i ligjshmërisë mbi sistemimin e zyrtarëve nga Stacioni Policor - Skënderaj,
- (b) Pajisjet policore në funksion të aktiviteteve operative dhe administrative,
- (c) Vlerësimi i menaxhimit të Njesisë së Mbrojtjes së Afërt,
- (d) Vlerësimi i kushteve të punës në njësitë e specializuara në Kampin Belvedere,
- (e) Vlerësimi i masave të sigurisë në objektet me rëndësi të veçantë,
- (f) Vlerësimi i veprimeve policore në trajtimin e rastit të dhunës në familje (H.M),
- (g) Vlerësimi i trajtimit të rasteve nga njësitë hetimore, të iniciuara nga ATK-ja.

Programet e punës inspektuese

Mbi bazën e Planit Vjetor të Inspektimeve janë nxjerrë Programet e punës inspektuese. Para se të hartohen Programet e tilla sipas kornizës kohore të përcaktuar, Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi ka kryer para-studim të fushave përkatëse, duke synuar të njohë më mirë veprimtarinë policore, të studiojë planet, legjislacionin, organizimin, burimet policore, aktivitetet dhe raportet policore. Programet e punës janë hartuar nga Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, dhe janë propozuar nga Udhëheqësi i Departamentit. Ato më pas janë miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së. Janë nxjerrë 12 Programe të punës inspektuese, (5 për inspektime të rregullta dhe 7 të tjera për inspektime të jashtëzakonshme). Programet e punës kanë përmbajtur elementet, si: arsyet e inicimit të inspektimit, objektin, subjektin, shtrirjen, objektivat, periudhën e mbulimit dhe realizimit, kriteret (standardet), etj.

Inspektimi

Faza përgatitore për zhvillimin e inspektimeve

Para fillimit të inspektimeve janë koordinuar veprimet me udhëheqësit e divizioneve dhe janë organizuar shpalosjet e Programeve. Janë organizuar 12 takime, në të cilat janë shpalosur Programet para ekipeve të inspektimit, nga Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi. Qëllimi i takimeve ka qenë që të pasqyrohet i gjithë informacioni mbi fushat e inspektimit. Ekipeve të inspektimit u është ndarë kohë e nevojshme për t'u përgatitur për inspektime.

Njoftimi i Policisë për fillimin e inspektimit

Para fillimit të çdo inspektimi të rregullt është njoftuar struktura përkatëse për inspektimet. Në pesë (5) raste, struktura përkatëse policore është njoftuar më parë (inspektim i rregullt), kurse për shtatë (7) tjera të jashtëzakonshme, njoftimet janë bërë me të filluar inspektimet, për shkak të specifikave dhe natyrës së tyre.

Autorizimi për inspektim

Për realizimin e inspektimeve, inspektorët janë autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së. Autorizimet janë lëshuar në 12 raste dhe kanë përmbajtur informatë mbi bazën ligjore, fushat inspektuese, periudhat e realizimit, përbërjet e ekipeve, qëllimet, përgjegjësitë e inspektorëve.

Mbledhja e të dhënave gjatë inspektimit

Me fillimin e punës inspektuese, ekipet janë takuar me udhëheqës të strukturave përkatëse policore që kanë qenë subjekt i inspektimeve. Janë organizuar 12 takime të këtij karakteri, ku brenda tyre janë prezantuar ekipet, aktivitetet, objektivat, procedurat e punës dhe raportimit. Inspektorët kanë përdorë metoda e teknika të mbledhjes së të dhënave, përfshirë intervista, kontrolle, verifikime me formularë, marrjet e dokumenteve, etj. Inspektorët kanë realizuar 177 takime me bartës të funksioneve, zyrtarë të uniformuar, shërbyes civil, si dhe persona të ndaluar në qendra të ndalimit, kanë siguruar 983 dosje varësisht nga fusha dhe një numër të raporteve, planeve dhe dokumenteve.

Mbikëqyrja e punës inspektuese

Inspektimet janë mbikëqyrur nga Udhëheqësi i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit. Ky vlerësim shërben për të identifikuar dobësitë e evidentuara në inspektim, nevojat për trajnime dhe performancën e inspektorëve. Divizioni për Inspektim dhe Raportim ka hartuar gjithsej 12 raporte të mbikëqyrjes së punës.

Raportimi

Përpilimi i draft raporteve të inspektimeve

Ekipet kanë trajtuar provat, mbledhur përmes metodave dhe teknikave të autorizuara, kanë vlerësuar pritjet e opinionit dhe kanë hartuar 12 draft raporte të inspektimit.

Rishikimi i draft raporteve të inspektimit

Pasi janë përpiluar draft raportet e inspektimit, i janë nënshtruar rishikimit përmes dëgjimeve në Departament, në koordinim me divizionet. Janë organizuar 11 dëgjime, kurse rishikimet kanë synuar ngritjen e cilësisë së raporteve. Gjatë rishikimeve është vlerësuar përmbledhja e informatave, prezantimi logjik i materies, përfundimet, rekomandimet, formatet, gjuha e përdorur. Lidhur me aktivitetet, Udhëheqësi i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi ka hartuar gjithsej 11 raporte mbi respektimin e standardeve të raportimit.

Dorëzimi i draft raporteve të struktura e inspektuar

Draft raportet e inspektimit janë përcjellur tek Kryeshefi Ekzekutiv dhe më pas janë dorëzuar tek struktura policore e inspektuar. Njoftimet kanë përmbajtur informata mbi nxjerrjen e draft raporteve të inspektimeve, mundësitë për organizimin e takimeve për shqyrtimin e gjetjeve, rekomandimeve dhe pajtueshmërinë lidhur me Planin e Veprimit.

Takimet pajtuese lidhur me gjetjet e inspektimit

Departamenti i Inspektimit ka organizuar 11 takime me struktura policore të inspektuara dhe lidhur me to janë mbajtur procesverbale. Në takime janë paraqitur argumente - kundër argumente për pjesë të draft raporteve. Lidhur me rezultatet e takimeve, strukturat policore të inspektuara kanë dërguar komentet lidhur me gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet dhe në koordinim me Departamentin e Inspektimeve është arritur pajtueshmëria për përmbushjen e rekomandimeve bazuar në Planin e Veprimit.

Hartimi dhe dorëzimi i raporteve të inspektimit

Pas përfshirjes së komenteve, si dhe Planit të Veprimit në raportet e inspektimit, këto janë dorëzuar për miratim tek Kryeshefi Ekzekutiv. Ky autoritet ka miratuar dhjetë (10) raporte të inspektimit. Më pas, raportet i janë shpërndarë Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Raportet më pas janë publikuar në faqen zyrtare të IPK-së, duke konsideruar se përmbajtja e tyre nuk rrezikon sigurinë e ndonjë personi, sigurinë publike, hetimet penale apo sigurinë kombëtare (4 sosh nuk janë publikuar për shkak të ndjeshmërisë së tyre).

Analiza dhe vlerësimi i procesit të inspektimit

Me përfundimin e proceseve të inspektimit, janë analizuar proceset e tilla, me qëllim të identifikimit të dobësive që kanë mundur t'i karakterizojnë ato. Janë mbajtur edhe takimet ku janë analizuar gjithë aspektet, duke filluar nga planifikimi, deri tek publikimi i raporteve. Pas analizave të bëra, janë vlerësuar aspektet e përmendura dhe Udhëheqësi i Departamentit ka nxjerrë raporte të veçanta mbi analizën dhe vlerësimin e proceseve inspektuese. Numri i këtyre raporteve është dhjetë (10) dhe të njëjtat i janë prezantuar Kryeshefit Ekzekutiv.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR INSPEKTIMET E REALIZUARA

Inspektimi nr. 01/2022:

Administrimi i parave të imëta në Policinë e Kosovës

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta i Departamentit të Inspektimit të IPK-së për vitin 2022 ka përfshirë kryerjen e inspektimit për administrimin e parave të imëta. Për nevoja operative dhe administrative shpesh herë dalin nevoja të paparashikueshme, të cilat parashihen të mbulohen nga fondet e parave të imëta, por që nuk duhet të kalojnë vlerat mbi 100 euro. Lidhur me këtë, disa strukturave policore u lejohet mbajtja e një sasive parash të imëta, për të cilat ekzistojnë rregullat e procedurat se si duhet administruar. Duke konsideruar se inspektimi është instrument i suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 15 shkurt 2022 ka iniciuar një inspektim të rregullt. Objektivi i këtij inspektimi ka qenë që të vlerësohet respektimi i rregullave dhe procedurave të shpenzimit të parave të imëta (petty cash). Inspektimi është përqendruar në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa. Gjatë inspektimit janë zhvilluar dy (2) takime me punonjës përgjegjës të strukturës policore. Janë kryer edhe kontrole të 14 dosjeve të administrimit të parave të imëta. Në këtë inspektim janë dhënë katër (4) rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit Veprues.

Inspektimi nr. 02/2022

Administrimi i patentë shoferëve të konfiskuar

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta i Departamentit të Inspektimit të IPK-së për vitin 2022 ka përfshirë kryerjen e inspektimit për administrimin e patentë shoferëve të konfiskuar nga Policia. Në përmbushje të mandatit për një siguri më të madhe në trafikun rrugor, ekipet patrulluese në kuadër të masave proaktive e reaktive, ekzekutojnë gjopa për kundërvajtësit por edhe konfiskojnë patentë shoferët që për pasojë kanë shqiptimin e pikëve negative dhe ndalimin e të drejtuarit të mjetit motorik për periudha të caktuara kohore. Duke konsideruar se inspektimi është instrument i suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 21 shkurt 2022 ka iniciuar inspektim të rregullt. Objektivi i inspektimit ka qenë të vlerësohet administrimi i patentë shoferëve të konfiskuar nga njësitë policore. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime dhe intervista me 17 drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturës përkatëse policore dhe janë kryer këqyrje - verifikime të 389 dosjeve të kundërvajtjeve në trafik. Lidhur me inspektimin janë dhënë tre (3) rekomandime që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën përkatëse policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 03/2022:

Vlerësimi i ligjshmërisë lidhur me sistemimin e zyrtarëve nga Stacioni Policor i Skenderajt

Me propozim të Udhëheqësit të Departamentit për Menaxhimin e Ankesave, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, më 12 prill 2022 ka kërkuar realizimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar ligjshmërinë e sistemimit të zyrtarëve policor, me theks të veçantë të transfereve të përkohshme nga Stacioni Policor i Skënderajt. Propozimi ka ardhur si rezultat i pranimit të ankesave nga disa zyrtarë policor të këtij Stacioni, pas shqetësimeve të tyre mbi mënyrën e sistemimit (transferimit) të tyre jashtë Stacionit. Objektivat e inspektimit kanë qenë: vlerësimi i ligjshmërisë në lëvizjen e burimeve brenda strukturës; vlerësimi i respektimit të parimeve të trajtimit të barabartë dhe të mos diskriminimit; vlerësimi i respektimit të kërkesave dhe kushteve të vendeve të punës me rastin e lëvizjes të zyrtarëve policor. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me gjashtë (6) drejtues dhe bartës të funksioneve të strukturës përkatëse policore, si dhe janë kryer këqyrje - verifikime të 84 dosjeve të personelit lidhur me sistemimet dhe transferet. Lidhur me inspektimin është dhënë një (1) rekomandim që i atribuohet gjetjeve dhe me strukturën përkatëse policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 04/2022:

Pajisjet policore në funksion të aktiviteteve operative dhe administrative

Me propozim të Udhëheqësit të Departamentit të Hetimeve, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, më 28 shkurt 2022 ka kërkuar realizimin e një inspektimi të jashtëzakonshëm, për të vlerësuar nivelin e pajisjes së strukturës policore, me pajisje operative, administrative dhe mbështetëse. Propozimi ka ardhur si rezultat i identifikimit të vështirësive logjistike, në të cilat kanë hasur hetuesit e IPK-së në disa stacione. Objektivat e inspektimit kanë qenë: identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të pajimit të stacioneve me pajisje; identifikimi i ciklit jetësor të pajisjeve dhe funksionalitetit të tyre; vlerësimi i azhuritit (ekspeditivitetit) të operatorëve të kontraktuar, në përmbushjen e kushteve të kontratave për mirëmbajtje të pajisjeve; identifikimi i nevojave për pajisjet e IT-së dhe pajisjeve tjera policore. Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me 41 zyrtarë të logjistikës dhe janë kryer verifikime të gjendjes dhe prezencës fizike të pajisjeve. Në inspektim janë dhënë katër (4) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 05/2022:

Vlerësimi i menaxhimit të Njësisë së Mbrojtjes së Afërt

Më 1 qershor 2022, Kryeshefi Ekzekutiv ka kërkuar që të realizohet inspektim i jashtëzakonshëm në NJMA, për të vlerësuar procedurat e përzgjedhjes dhe të avancimit, procesin e verifikimit, gjendjen shëndetësore dhe kushtet e punës në Njësi. Objektivat e inspektimit kanë qenë: vlerësimi i kapaciteteve njerëzore, teknike dhe operative të NJMA-së, si dhe vlerësimi i performancës dhe shërbimeve të ofruara të sigurisë. Bazuar në metodologjinë e përcaktuar, janë realizuar gjashtë (6) intervista - takime me drejtues dhe bartës të funksioneve, si dhe janë kryer kontrole të dosjeve të personelit dhe kushteve të punës. Në këtë inspektim janë dhënë gjashtë (6) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 06/2022:

Menaxhimi i procedurave të arrestimit dhe ndalimit

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta në vitin 2022 ka paraparë kryerjen e inspektimit në fushën e menaxhimit të procedurave të arrestimit dhe ndalimit. Policia gjatë kryerjes së detyrave ndodhë që të arrestojë apo ndalojë persona nën dyshimin se kryejnë vepra të kundërligjshme. Nga këto veprime policore lindin edhe përgjegjësi për Policinë, për t'i trajtuar me dinjitet personat e tillë. Trajtimi dinjitoz i personave kërkon respektimin e të drejtave të tyre, por edhe krijimin e kushteve për mbajtje. Jo gjithëherë personat e arrestuar dhe ndaluar trajtohen në mënyrën e duhur, andaj duke konsideruar se inspektimi është instrument i suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe të menaxhimit, Kryeshefi Ekzekutiv më 31 maj 2022, ka iniciuar inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit. Objektivat e inspektimit kanë qenë: që të vlerësohet trajtimi i personave të ndaluar dhe respektimi i të drejtave të tyre; që të vlerësohet administrimi i dosjeve të personave të ndaluar në qendrat e ndalimit; që të vlerësohen kushtet fizike dhe të sigurisë në qendrat e ndalimit; si dhe që të vlerësohet përmbushja e rekomandimeve nga inspektimet e kaluara. Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime- intervista me 21 përgjegjës të qendrave të ndalimit dhe me 20 persona të ndaluar; janë kryer inspektime - kontrole fizike të kushteve fizike e sigurisë, si dhe të 342 dosjeve të ndalimit. Janë dhënë gjashtë (6) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 07/2022:

Menaxhimi i thirrjeve dhe reagimit policor

Plani Vjetor ka paraparë kryerjen e inspektimit mbi menaxhimin e thirrjeve dhe reagimit policor. Stacionet sfidohen shpesh herë për të reaguar me kohë në thirrjet e qytetarëve. Janë një numër faktorësh që sfidojnë dhe vështirësojnë reagimin e duhur në vendngjarje, andaj duke konsideruar se inspektimi paraqet instrument shumë të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe të menaxhimit, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 1 korrik 2022 ka iniciuar inspektim për vlerësuar performancën policore në këtë fushë menaxhimi. Objektivi i inspektimit ka qenë matja dhe analiza e kohës së reagimit, nga momenti i pranimit të thirrjeve, deri në arritjen e njësive policore në vendngjarje. Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime - intervista me 41 drejtues dhe bartës funksionesh në nivel stacionesh; janë kryer verifikime të 123 logjeve mujore operationale, të rezultuara me matje të 15.105 mostrave të reagimit. Lidhur me inspektimin janë dhënë pesë (5) rekomandime që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 08/2022

Vlerësimi i kushteve të punës në njësitë e specializuara në Kampin Belvedere në Mitrovicë

Më 6 shtator 2022, Kryeshefi Ekzekutiv ka kërkuar që të realizohet inspektim i jashtëzakonshëm në njësitë e specializuara, të stacionuara në Kampin Belvedere, për të vlerësuar kushtet e punës, përfshirë këtu pajisjet, ushqimin dhe inventarin e këtyre njësive, si dhe aspektet që lidhen me sigurinë e Kampit. Propozimi ka ardhur si rezultat i kërkesës së Ministrisë të Punëve të Brendshme. Objektivat e inspektimit kanë qenë: vlerësimi i kapaciteteve teknike dhe operative të njësive të specializuara, dhe vlerësimi i kushteve të punës dhe masave të sigurisë. Bazuar në metodologjinë e përcaktuar të inspektimit janë realizuar dhjetë (10) takime - intervista me drejtues dhe bartës funksionesh, si dhe janë kontrolluar kushtet e punës dhe masat e sigurisë. Lidhur me inspektimin janë dhënë pesë (5) rekomandime që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 09/2022

Vlerësimi i veprimeve policore në trajtimin e rastit të dhunës në familje (H.M)

Me kërkesë të Kryeshefit Ekzekutiv me datë 13.12.2022 është iniciuar inspektim i jashtëzakonshëm për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga stacionet policore (Shtime dhe Lipjan), gjatë trajtimit të rastit "Dhunë në familje", me pasojë vrasjen e viktimës shtatzënë (HM). Inspektimi ka synuar të vërë në pah veprimet apo mosveprimet në trajtimin e rastit nga Policia, si një nga akterët e mandatuar të parandalojë dhe luftojë krimin në shoqëri dhe krijimin e një mjedisi më të sigurt për qytetarët. Dhuna në familje është krim, luftimi i të cilit mbetet përgjegjësi e shumë akterëve, të përcaktuar dhe me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna Ndaj Grave (2022-2026). Dokumenti parasheh hetim efektiv, përgjigje të shpejt në thirrjet për ndihmë, menaxhim të duhur të situatave me rrezik dhe hetim për të gjitha akuzat për dhunë ndaj grave dhe dhunës në familje. Objektivat e inspektimit kanë qenë: vlerësimi i veprimeve policore dhe masave të ndërmarra të sigurisë gjatë trajtimit të rastit të raportuar për dhunë në familje. Bazuar në metodologjinë e përcaktuar të inspektimit: janë realizuar takime - intervista me dy (2) drejtues dhe bartës të funksioneve, si dhe janë verifikuar dokumentet, si: regjistrat, raportet, oraret, dosjet e rastit, logjet operacionale, listat e trajnimit, etj. Lidhur me inspektimin janë dhënë gjashtë (6) rekomandime që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 10/2022

Vlerësimi i masave të sigurisë në objektet me rëndësi të veçantë

Me kërkesë të Kryeshefit Ekzekutiv me datë 02.11.2022 është iniciuar inspektim i jashtëzakonshëm për të vlerësuar masat e sigurisë në objektet me rëndësi të veçantë, duke përfshirë Kuvendin, Presidencën, Kryeministrinë, objektet ministrore dhe rezidenciale. Në fokus të këtij inspektimi kanë qenë burimet njerëzore të angazhuara në sigurimin e objekteve në fjalë, objektet, pajisjet, masat e sigurisë dhe angazhimet lidhur me sigurimin dhe kontrollin e personave, hapësirave dhe automjeteve. Objektivi i këtij inspektimi ka qenë: vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike, si dhe masave të ndërmarra në funksion të ofrimit të sigurisë në objektet me rëndësi të veçantë. Bazuar në metodologjinë e inspektimit janë realizuar pesë (5) takime - intervista me drejtues dhe bartës të funksioneve, si dhe janë verifikuar shërbimet dhe masat e sigurisë në objektet me rëndësi të veçantë, përfshirë Presidencën, Kuvendin, Qeverinë, Kompleksin Qeveritar (ish Rilindja) dhe Gjykatën Kushtetuese. Lidhur me inspektimin janë dhënë shtatë (7) rekomandime që i atribuohen gjetjeve dhe me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

8. PLANIFIKIMI STRATEGJIK, ÇËSHTJET LIGJORE, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI

Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe si i tillë funksionon nga viti 2017.

Përgjegjësitë (detyrat) e këtij Departamenti janë:

- udhëheqë aktivitetet në nxjerrjen e planeve strategjike, bazuar në objektivat strategjike të Ministrisë, si dhe vlerëson zbatimin e planeve për përmbushjen e objektivave strategjike;
- siguron shërbime juridike/këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale;
- udhëheqë aktivitetet për nxjerrjen, rishikimin- plotësimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe PSO-ve lidhur me funksionet e IPK-së;
- udhëheqë me aktivitetet në zhvillimin dhe avancimin e bashkëpunimit e partneritetit ndër institucional brenda dhe jashtë vendit;
- udhëheqë aktivitetet e organizatës në ofrimin e shërbimeve profesionale në fushëne komunikimit dhe informimit publik;
- udhëheqë me aktivitetet për të siguruar realizimin e politikave në promovimin e vlerave, me qëllim të ngritjes së besimit dhe fuqizimit të rolit mbikëqyrës të IPK-së.

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM, BASHKËPUNIM, ÇËSHTJE LIGJORE DHE INFORMIM

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi 60 komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi 200 kërkesa të tyre;
- Realizuam takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore etj.

DPBÇLI zhvillon aktivitetin në dy (2) divizione:

- Divizionin për Planifikim dhe Çështje Ligjore;
- Divizionin për Bashkëpunim dhe Informim.

Departamenti ka të punësuar gjashtë (6) punonjës.

IPK-ja gjatë vitit 2022 është angazhuar në përmbushjen e detyrave që kanë dalë nga Plani Zhvillimor Strategjik 2022 - 2024 dhe detyra të tjera sipas nevojave. Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun, bashkëpunimit vendor e ndërkombëtar, planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore, IPK i ka realizuar përmes Departamentit për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim (tutje si DPBÇLI).

DPBÇLI është angazhuar në aspektin e planifikimit strategjik duke përgatitur Planin Vjetor dhe Planin e Veprimit, pastaj përgatitjen dhe azhurnimin e Listës së Analizës së Riskut për IPK-në, finalizimin e Procedurave Standarde të Operimit etj. Angazhimet e DPBÇLI-së janë fokusuar edhe në fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë, institucione vendore dhe ndërkombëtare.

a) Bashkëpunimi me institucionet vendore

Në kuadër të bashkëpunimit vendor, DPBÇLI kanë pasur aktivitete me rëndësi në fuqizimin e këtij bashkëpunimi. Si pikë e kontaktit me institucionet vendore, janë trajtuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur në adresën e IPK-së. Në bashkëpunim me departamentet e tjera, janë kthyer përgjigjet në MPB mbi raportimet për përmbushjen e objektivave strategjike të Planit të MPB-së dhe Qeverisë. DPBÇLI ka trajtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, si dhe ka raportuar te Zyra e Kryeministrit mbi numrin e kërkesave të trajtuara.



Në kuadër të angazhimeve me institucionet e tjera, është ngritur niveli i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për fushën e të drejtave e lirive të njeriut. DPBÇLI ka trajtuar kërkesat që kanë ardhur nga ky institucion, respektivisht nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Janë trajtuar kërkesat e ardhura nga Avokati i Popullit, përfshirë edhe kërkesat për hapjen e rasteve sipas detyrës zyrtare.

Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore dhe menaxhmenti kanë fuqizuar bashkëpunimin me Prokurorin e Shtetit në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe veprave tjera të penale. Kjo ka ndikuar që IPK dhe Prokuroria

e Shtetit zhvillojnë raporte të bashkëpunimit në luftimin e dukurive negative, të cilat hasen Polici, e në veçanti në luftimin e korrupsionit, përmes shkëmbimit të informatave dhe trajtimit të tyre mbi dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor.

Bashkëpunimi me Policinë është i orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse.

Gjatë vitit 2022 u nënshkrua edhe Memorandumi i Bashkëpunimit me Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK). Kjo marrëveshje u nënshkrua me qëllim të avancimit dhe thellimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve, për të mbështetur njëra tjetrën në



përmbushjen e mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor.

Marrëveshja përveç tjerash përfshin bashkëpunimin për mbështetje në aspektin e sigurisë gjatë transportimit të të burgosurve, shkëmbimin reciprok të informatave bazuar në autorizimet ligjore të dy institucioneve, mbështetjen reciproke në çështje të trajnimeve në fushat me interes për të dy palët etj.

b) Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun

Varësisht sipas nevojave operative në teren, në bashkëpunim me departamente të ndryshme në kuadër të IPK-së janë publikuar komunikata për media, janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë vitit nga DPBÇLI në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë kanë qenë:

- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media;
- dhënia e deklaratave për mediet;
- angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- përgjigjja në kërkesat e adresuara nga mediet e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së
- Kërkesat për qasje në dokumente publike etj.
- Përgatitja e Planit vjetor të IPK-së.

Në kuadër të këtyre angazhimeve janë trajtuar me qindra kërkesa përmes telefonatave të ndryshme nga mediat, mbi 250 kërkesa me shkrim të adresuara në adresën zyrtare të Divizionit për bashkëpunim dhe informim (DBI) si dhe janë publikuar më shumë se 60 komunikata për medie lidhur me aktivitetet e ndryshme të IPK-së.

Përveç këtyre angazhimeve ky Divizion ka përgatitur në baza të rregullta analizën – raportin e shtypit ditor lidhur me ngjarjet që janë mbuluar nga mediat dhe i cili është shpërndarë te zyrtarët e IPK-së.

DBI ka administruar dhe ka përditësuar edhe rrjetet sociale me fokus të veçantë në Facebook-un zyrtar. Secila komunikatë e cila është përcjellë për publikim në ueb faqen zyrtare është publikuar edhe në Facebook duke rritur në këtë mënyrë edhe numrin e ndjekësve në këtë rrjet social.

Divizioni për bashkëpunim dhe informim me përkrahjen e ICITAP-it dhe misionit të OSBE-së gjatë vitit 2022 ka organizuar dhe marrë pjesë në disa aktivitete që kanë ndikuar në adresimin e ankesave të qytetarëve përmes formave të tjera si uebit zyrtar apo Linjës së kaltër.

Ndër temat që janë trajtuar në këto aktivitete kanë qenë:

- Rrugëtimi i IPK-së ndër vite – historik i shkurtër;
- Roli dhe misioni i IPK-së;
- Funkionimi i zyrave rajonale (si mundësi shtesë për qytetarë);
- Angazhimet e zyrtarëve të IPK-së gjatë kohës së Pandemisë dhe mundësia e raportimit të rasteve përmes platformave online;

- Bashkëpunimi me qytetarë;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;
- Rastet më të shpeshta që hetohen nga IPK-ja;
- Integriteti policor;
- Linja e kaltër etj.

Një aktivitet i tillë është realizuar përmes ligjërës së autorizuar me studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Tema e trajtuar gjatë këtij aktiviteti/ligjërës që u realizua me përkrahjen e stafit akademik të Fakultetit të Sigurisë në AKSP në Vushtrri ishte “Roli dhe rëndësia e integritetit të zyrtarët e agjencive të sigurisë”.



Gjatë diskutimit të hapur me studentët u diskutua për integritetin policor, sfidat që përcjellin organizatat drejt fuqizimit të integritetit, kodin e heshtjes, ndërlidhja e integritetit policor me besueshmërinë e qytetarëve në polici etj.

Përveç kësaj, pjesëmarrësit diskutuan së bashku për sfidat më të mëdha dhe prioritetet kryesore për fuqizimin e integritetit të agjencive të sigurisë në përgjithësi e integritetit policor në veçanti.

Publikimi i revistës “Integriteti” dhe buletinit mujor “Linja e Kaltër”




Ndër angazhimet e IPK-së në vitin 2022 për fuqizim të transparencës ka qenë edhe publikimi i revistës së rregullt “Integriteti”. Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, kjo revistë konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve policor, partnerëve dhe qytetarëve për angazhimet e IPK-së.

Përveç revistës “Integriteti” në vitin 2022 IPK respektivisht Divizioni për bashkëpunim dhe informim ka vazhduar me projektin që i referohet fuqizimit të transparencës së brendshme duke publikuar çdo muaj buletinin e titulluar “Linja e Kaltër”.

c) Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi me ICITAP-in



IPK-ja çmon lartë bashkëpunimin me ICITAP-in, i cili është i rëndësishë së veçantë. ICITAP ka ndihmuar IPK-në edhe këtë vit në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe teknike. Trajnimet që ka ofruar ICITAP-i ndër vite, kanë qenë mëse të nevojshme për IPK-në dhe të duhura për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së. Gjatë këtij viti, IPK është përkrahur me trajnime specifike që kanë fuqizuar kapacitetet profesionale.

ICITAP-i përkrahu IPK-në vitin e kaluar për anëtarësim në NIAIA dhe në shkëmbimin e përvojave me agjenci të zbatimit të ligjit të SHBA-ve.

Kurse këtë vit, IPK me përkrahjen e ICITAP-it mori pjesë edhe në konferencën profesionale të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Clearwater - Florida në SHBA.

Delegacioni i IPK-së u mirëprit nga Kryetari i bordit Kapiten Chris Ray dhe zyrtarë tjerë të delegacioneve pjesëmarrëse, me të cilët po diskutohet për sfidat e mbikëqyrjes policore dhe rëndësinë e shkëmbimit të përvojave nga agjencitë homologe.



Konferenca u zhvillua nga data 17 deri 23 Shtator 2022, ku ndër tjera u diskutua për rëndësinë e integritetit të zyrtarëve policorë, metodat e hetimit dhe luftimit të rasteve të keqpërdorimit të detyrës, përdorimit të forcës, përdorimi i rrjeteve sociale, si dhe trendet në hetimet e brendshme dhe mbikëqyrjen e organeve të zbatimit të ligjit. Delegacioni i IPK-së dhe zyrtarët e ICITAP-it amerikan në Kosovë gjatë qëndrimit atje zhvilluan një vizitë zyrtare në Departamentin e Policisë në Clearwater/Florida të SHBA-ve.

Me përkrahjen e ICITAP-it, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së së bashku me Drejtorin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP-së) të Republikës së Shqipërisë në fund të muajit korrik pritën në takim Zëvendës ndihmës sekretaren e Departamentit Shtetit të SHBA-ve Lisa A. Johnson dhe përfaqësues nga Sektori për Diplomaci publike.

Takimi u zhvillua në pikën e përbashkët kufitare në Vërmicë ku ndër tjera u prezantua puna e përbashkët në realizmin me sukses të operacionit antikorrupsion "Pika 1 dhe 2".



Kryeshefi i IPK-së z. Hodaj dhe Drejtori i AMP-së z. Rrumbullaku, falënderuan znj. Johnson për ndihmën e Departamentit të Shtetit përmes INL-t (Byroja Ndërkombëtare për Lëndë Narkotike dhe Zbatim të Ligjit) dhe ICITAP në fuqizimin e kapaciteteve profesionale të agjencive përkatëse.

Ndihmës sekretarja Johnson vlerësoi lart suksesin e IPK-së dhe AMP-së në realizimin me sukses të operacionit Pika 1 dhe 2 dhe shprehu gatishmërinë e SHBA-ve në mbështetjen edhe me të fuqishme të institucioneve në luftimin e korrupsionit në polici si fenomen që dëmton

besimin e qytetarëve në institucione të zbatimit të ligjit.

Gjatë këtij viti IPK u përkrah nga ICITAP edhe për një udhëtim studimor me bazë në SHBA në Zyrën e Policisë Shtetërore të Njësisë të Standardeve Profesionale të Uashington DC dhe Virxhinia.

Bashkëpunimi me OSBE-në

Misioni i OSBE-së në Kosovë gjatë vitit 2022 ka ofruar përkrahje për IPK-në me trajnime të specializuara dhe me donacione të ndryshme. Përveç trajnimeve në fushën e mbikëqyrjes policore dhe fushës së komunikimit strategjik, Misioni i OSBE-së këtë vit i dorëzoi IPK-së një donacion prej 33 libra që mbulojnë fushën e mbikëqyrjes policore dhe menaxhimit policor

Në mungesë të librave profesional në gjuhën shqipe që mbulojnë fushën e mbikëqyrjes policore dhe shkencës së menaxhimit policor, ky donacion i titujve profesional në gjuhën angleze konsiderohet i rëndësishëm për fuqizimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të IPK-së.

Furnizimi me këto libra pritet të ketë ndikim pozitiv në ngritjen e nivelit të profesionalizimit të IPK-së duke fituar njohuri të reja për fushat e lartcekura por edhe në aspektin e realizimit të aktiviteteve të natyrës preventive bazuar në qasje shkencore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.



9. SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMET E PËRGJITHSHME

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka rol mbështetës në menaxhimin e buxhetit, burimeve njerëzore, sistemeve të Teknologjisë Informative dhe shërbimeve logjistike në arritjen e objektivave të IPK-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DFSHP-së janë: menaxhon dhe mirëmban informatat për burimet njerëzore të IPK-së, asiston menaxhmentin në organizimin e brendshëm, ofron mbështetje administrative, logjistike dhe të shërbimeve të teknologjisë informative, siguron zbatimin e procedurave për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit të kualifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të IPK-së, koordinon zbatimin me kohë të detyrimeve financiare të IPK-së, menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të IPK-së, ofron shërbime logjistike për IPK-në, mirëmban pajisjet e TI-së dhe ofron shërbime të TI-së.

DFSHP ka të punësuar 18 punonjës dhe është i strukturuar në tre divizione:

- Divizioni për Buxhet dhe Financa;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore; dhe
- Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike.

DFSHP ka ofruar këto shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

- Menaxhimin e buxhetit të ndarë i cili është realizuar 81.14 %;
- Menaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Teknologjisë Informative;
- Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së;
- Menaxhimin e pandemisë Covid-19 duke respektuar rekomandimet e IKSHPK-së dhe Vendimet e Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë;
- Realizimin e Planit të dalë nga Strategjia e Trajnimeve të IPK-së.

DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

Ofruam shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

Menaxhuam buxhetin e ndarë dhe realizuam 81.14 % të tij;

Vazhduam ndërlidhjen e data bazave me Policinë e Kosovës dhe ARC-në;

Organizuar trajnime bazuar në Strategjinë e Trajnimeve të IPK-së;

Realizuar projektet për renovim të objektit dhe rregullim të parkingut të IPK-së;

Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së

Misioni kryesor i DFSHP-së, është menaxhimi i drejtë, efikas dhe me nikoqirllëk me parat publike për nevojat e IPK-së, në pajtueshmëri të plotë me Ligjin me Nr. 03/L-0481 për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji nr. 05/L-0632 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-2213, Nr. 04/L-1164 dhe Nr. 04/L-1945, si dhe me rregulloret dhe udhëzimet administrative financiare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, me qëllim të arritjes së misionit dhe objektivave të parapara të IPK-së.

Tabela: Buxheti Final dhe Shpenzimet 2022:

	Buxheti FINAL	Shpenzimi	Mbetja/Bu.	Shp./Bu.(%)
Paga dhe Shtesa	1,069,139.00	1,039,860.85	29,278.15	97.26
Mallra dhe Shërbime	622,036.00	343,282.83	278,753.17	55.19
Shpenzimet Komunale	15,300.00	3,906.41	11,393.59	25.53
Projekte Kapitale	3,000.00	0.00	3,000.00	0.00
Totali	1,709,475.00	1,387,050.09	322,424.91	81.14

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Inspektoratin Policor të Kosovës ka vazhduar ndërlidhjen e data bazave me Policinë e Kosovës dhe Agjencinë për Regjistrim Civil dhe tani përveç qasjes në databazat e PK-së, IPK ka qasje edhe në data bazat e regjistrit civil dhe në data bazën e regjistrit të automjeteve të cilat i shërbejnë stafit të Departamentit të Hetimeve.

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka bërë menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së, ku aktualisht flota posedon dyzet e nëntë (49) vetura zyrtare. Prej tyre, tridhjetë e nëntë (39) vetura zyrtare ose tetëdhjetë për qind (80%) e tyre janë vetura të cilat përdoren aktivisht nga punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës. Ndërsa dhjetë (10) vetura zyrtare të tjera ose njëzet për qind (20%) e tyre janë vetura të cilat janë jashtë përdorimit në IPK.

Zyra e Transportit në vazhdimësi ka trajtuar kërkesat për servisin e automjeteve, ka hartuar autorizimet, si dhe ka bërë sigurimin dhe regjistrimin e të gjitha automjeteve.

Gjithashtu zyra e transportit ka bërë edhe inspektime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të flotës dhe po ashtu vazhduar të mbaj të dhënat në kartelë fizike dhe elektronike mbi gjendjen e secilit automjet të IPK-së.

Me ndihmën e Misionit të OSBE-së ka filluar projekti për krijimin e platformës së ueb faqes së IPK-së, ku kjo platformë ka shumë përparësi në krahasim me platformën dhe dizajnin e ueb faqes së vjetër. Gjatë krijimit dhe ri-dizajnit të ueb faqes së re, rendësi të veçantë i është kushtuar pranimit të ankesave online, ku ankesat e marra nga ueb faqja do të mund të shfrytëzohen nga

Departamenti për Menaxhimin e Ankesave si statistika që gjenerohen nga CMS-i. Platforma e re ka edhe module tjera shtesë, si p.sh.: pyetjet e shpeshta, mundësinë e thirrjes automatike nga ueb faqja në numrin e telefonit të Linjës së kaltër, zyrtarin për sinjalizim në IPK, formularin për qasje në dokumente publike, si dhe shumë pjesë tjera të cilat janë shumë më efikase dhe efektive se sa platforma e vjetër.

Trajnimet profesionale për stafin e IPK-së kanë qenë të reduktuara për shkak të pandemisë, edhe pse kanë arritur të mbahen disa të tilla kryesisht me përkrahjen e vazhdueshme të ICITAP-it , misionit të OSBE-së në Kosovë, IKAP dhe AKSP-së.

Tabelat në vijim prezantojnë numrin e trajnimeve dhe pjesëmarrësve në trajnimet për stafin operativ dhe atij administrativ të IPK-së.

TRAJNIMET/ PUNONJES OPERATIV				
Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Muaji	Zyrtar
1	Advanced Crime Scene Management and Investigation	EU	Janar	2
2	Krimet Ekonomike dhe Korrupsion	EU	Janar	2
3	Prezantimi i PDI-së (Policia e drejtuar nga Inteligjenca) për analiste	EU	Janar Shkurt	2
4	Aftësimi dhe përdorimi i droneve	ICITAP	Shkurt Mars	5
5	Skydo Expert Operator	SKYDIO	Mars	2
6	Trajnime për hetim të korrupsioni	DACF	Mars	10
7	Mbrojtja për sinjalizues	KE-IKAP	Mars Dhjetor	1
8	Luftimi i Rrjedhjes së Parasë	GIZI	Maj	5
9	On Smartphone Videography and Digjital Publik Relations	OSCE	Qershor	1
10	Forenzika Financiare	ICITAP	Qershor Korrik	2
11	Data baza		Korrik	2
12	Trajnime dhe Inspekte të prokurimit	EU	Gusht Shtator	9
13	Trajnime të avancuar për hetimin e narkotikeve	EU	Shtator	4
14	Laboratorët Klandestin	ICITAP	Shtator	2
15	Pjesëmarrja në konferencën e NIAIA-së	ICITAP	Shtator	4
16	Komunikimi dhe koordinimi në situatë krize	OSCE	Tetor	3
17	Trajnime për PDI analist	OSCE	Tetor	13
18	Trajnime të avancuar për hetim të krimit të organizuar	OSCE	Tetor	4
19	Trajnime Program On Applied Security Studies	ICITAP	Shtator Tetor Nëntor	1
20	Fotografimi i fshehtë	OSCE	Nëntor	13
21	Zhvillim i karrierës për gratë që punojnë në sektorin publik të Kosovës	BDO	Nëntor	1
22	Përgatitja për aplikim dhe intervistë në rekrutim të bazuar në meritë	BDO	Nëntor	1
23	Teknikat e avancuara për analistë	BE	Dhjetor	14
24	Trajnime të avancuar për hetime penale dhe forenzikë	OSCE	Dhjetor	12
25	Kamerat e trupit	ICITAP	Dhjetor	2
Totali i punonjësve që kanë ndjekur trajnimet				118

TRAJNIMET/ PUNONJES ADMINISTRATIV				
Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Muaji	Zyrtar
1	Moduli i aprovimeve dhe blerjeve	IKAP	Janar	1
2	Planifikimi strategjik i buxhetit dhe ndryshimeve buxhetore	IKAP	Mars	1
3	Mbrojtja për sinjalizues	KE-IKAP	Mars/Dhjetor	1
4	Microsoft Visio & Microsoft Publisher	IKAP	Prill	3
5	Siguria Kibernetike	ICITAP	Maj	1
6	On Smartphone Videography and Digital Publik Relations	OSCE	Qershor	1
7	Korniza e investimeve për Ballkanin perëndimor	IKAP	Qershor	1
8	Transferimi, pezullimi dhe përfundimi i marrëdhënies së punës në SHC	IKAP	Qershor	1
9	Zhvillimi i nëpunësve civil	IKAP	Qershor	1
10	Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	IKAP	Korrik	1
11	Trajnime dhe Inspektime të Prokurimit	EU	Gusht/Shtator	1
12	Administrimi i Punës në zyrë	IKAP	Shtator	1
13	Hartimi dhe përgatitja e kampanjave informuese	IKAP	Shtator	1
14	Standardet, kapitujt në Çështjet e Ekonomisë	IKAP	Shtator	3
15	Menaxhimi i Projekteve të TI-kut	IKAP	Tetor	1
16	Standardet, kapiturit në Çështjet e punësimit	IKAP	Tetor/Nëntor	2
17	Diversiteti kulturor dhe social	IKAP	Nëntor	2
18	Menaxhimi i ndryshimit dhe reformave	IKAP	Nëntor	1
19	Etika dhe integriteti në shërbimin publik	IKAP	Nëntor	2
20	Sjellja organizative	IKAP	Nëntor	2
21	Kamerat e trupit	ICITAP	Dhjetor	1
Totali i punonjësve që kanë ndjekur trajnimet				30

Gjatë këtij viti, në muajin gusht Divizioni për Teknologji Informative dhe Logjistikë në IPK, përmes Operatorit Ekonomik të kontraktuar, ka filluar realizimin e projekteve “Renovimi i objektit dhe Rregullimi i parkingut” të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Përmes projektit të renovimit është bërë zgjerimi i hapësirave të zyrave me mbi 30% i të gjitha zyrave dhe sallave në katet 1 dhe dy të objektit, si dhe është realizuar ngjyrosja e tyre.

Ndërsa përmes projektit *Rregullimi i parkingut* janë krijuar rreth 40 vend parkingje për automjetet zyrtare të IPK-së, si dhe katër vend parkingje të mbuluara (garazhe). E gjithë hapësira e vend parkingjeve është mbuluar nga ndriçimi i vendosur në Llampa ekonomike të tipit LED të cilat janë montuar në shtylla të çelikut me lartësi 8m. Parkingu është shtruar me kubëza të betonit dhe kubëza anësore ku janë vendosur vijat ndarëse mes parkingut dhe gjelbërimit, si dhe shtigjeve me trotuare për këmbësor, ndërsa në pjesën ku është bërë vetëm pastrimi i terrenit është vendosur humusi në trashësi 20cm, si dhe është bërë mbjellja e barit. Gjithashtu, rregullimi i kanalizimit për ujërat e zeza nga gropa septike deri tek lidhja me rrjetin e kanalizimit të qytetit.





INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE**



080003333

**Së bashku për një polici profesionale
Zajedno za profesionalnu policiju
Together for professional police**